

**PROFILI I PËRGJITHSHËM**

**PJESA I**

**LASGUSH PORADECI: VALLJA E YJEVE**

Yjtë - e ndezur si fëngjill  
Që vërtiten pale - palë,  
prej mosgjëje zunë fill  
Plot me jetë - e mall të valë.

Zunë fill me dashuri  
Që kur bota zu të ngjizet,  
Pa sikush për shok të ti  
Përvëlohet edhe ndizet.

Ndizet ças edhe për ças,  
E si kurrë s'ka të shuar,  
Pa pushim i vete pas  
Me një sulm të llaftaruar.

E sikur nuku mund  
Ylli yllin që ta kapë,  
Rrotull qiejve pa fund  
Venë - e - vinë - e venë prapë...

Do të venë fluturim  
Kudo janë - e kudo s'janë,  
Nëpër qiell që s'ka mbarim,  
As fillim, as fund, as anë.

.....

... Kur po ja! se që përtej  
Nditen erërat nga pakë:  
Ylli - i zhdukur nëpër qiej  
Vtetëtiu e mori flakë:

*Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

---

J - a pat shtënë më një ças'  
Mun në mes në kraharuar,  
Shoq' i vet q'i sillej pas  
Me një sulm të llaftaruar;

Q'e kish flakën mun në gji,  
Q'e zhuritte dashuria,  
Që shkëlqente me zili  
Rrotull rrezeve të tija.

Yll i mjerë e yll i lum!  
Yll i lum e yll i mjerë!  
Sapo drita t'u përgjum,  
Sheh një shoq nëpër skëterë;

Ay vin... e gjithë vin...  
Gjith më pranë ...e gjith më pranë ...  
Sesa ndrin e vetëtin!...  
Sesa ndjen një gaz pa anë! ...

Sesi ndritesh përsëri!  
Sesi ndizesh përsëpari!  
Sesi ndjek me dashuri  
posi yll margaritari!...

Dashuri! Heu! mall i ri!  
Dashuri! këng' e durimit!  
Ti liri! Ti robëri!  
Ti valim i shkrepëtimit!

Yjtë - e ndezur aqe larg.  
Lozin vallen e dëshirës  
Dyke ndritur varg - e - varg  
Nëpër terr të hapësirës

*Matura Shtetërore 2006, Teste*

---

*Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën e përgjigjes së saktë.*

1. Motivi i kësaj poezie, veç atij të dashurisë, është: **1 pikë**  
A) kozmogonik.  
B) i pasjetës.  
C) i natyrës.  
D) meditativ.
2. Lasgush Poradeci është përfaqësues i: **1 pikë**  
A) letërsisë së vjetër shqiptare.  
B) poezisë tradicionale shqiptare.  
C) prozës moderne shqiptare.  
D) poezisë moderne shqiptare.
3. Poradeci parapëlqen përdorimn e: **1 pikë**  
A) personifikimit.  
B) metaforës.  
C) metonimisë.  
D) simbolit.
4. Lirika erotike e Poradecit përfytyrohet si një trajektore që shkon nga: **1 pikë**  
A) Toka në Qiell.  
B) Toka në Ferr.  
C) Ferri në Parajsë.  
D) Toka në Përjetësi.
5. Përdorimi i shprehjes “*sulm i llaftaruar*” në këtë poezi ka të bëjë me: **1 pikë**  
A) forcën e goditjes.  
B) intensitetin e dashurisë.  
C) mllefën e urrejtjes.  
D) ritmin e valles.
6. Gjej në tekst foljet që tregojnë lëvizje (p.sh. *vërtiten, vinë*). A mendon se ky përdorim është i qëllimshëm? A ndikon kjo lëvizje në ritmikën e poezisë? **4 pikë**

*Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

---

7. Duke patur parasysh krijimtarinë e Poradecit si dhe duke u ndalur në dy strofat e fundit të këtij fragmenti rendit tri tipare të lirikës erotike të autorit. **3 pikë**
8. Vër re pranëvënien e epiteteve me kuptim të kundërt (*yll i mjerë e yll i lum*). Gjej në poezi të paktën tri raste të tjera. Shkruaj arsyen e këtij përdorimi të veçantë. **4 pikë**
9. Gjej në fragment një krahasim dhe një simbol. Shpjego se cili është roli i aliteracionit në strofën e 11-të. **3 pikë**
10. Cilat janë disa nga ndjenjat që e karakterizojnë këtë poezi? A mendon se ajo bën pjesë në lirikën erotike të ngjyrave të errëta të Lasgushit? Argumentoje mendimin tënd me vargje nga fragmenti. **6 pikë**

**PJESA II**

**HEMINGUEJ: PLAKU DHE DETI (FRAGMENT)**

Varka dridhej ende nga goditjet e peshkaqenit që hante peshkun brenda në ujë dhe plaku, duke lëshuar pëlhurën, e la varkën të kthehej mënjane, kështu që ta linte peshkaqenin të dilte sipër ujit. Kur e pa, u përkul mbi buzën e varkës dhe ia nguli thikën. Ai goditi vetëm mishin, por lëkura e trashë e peshkaqenit nuk e la thikën të futej më thellë. Plaku e goditi peshkaqenin kaq fort sa i dhembën jo vetëm duart, por edhe shpatullat. Por peshkaqeni nxori kokën nga uji dhe plaku e goditi mu në mes të kokës petashuqe, kur hunda doli nga uji që të kafshonte mishin. E nxori thikën dhe e futi për herë të dytë, po në atë vend. Peshkaqeni kishte shtrënguar fort nofullat dhe i qe kacavjerrë peshkut; plaku ia nguli thikën në syrin e majtë. Peshkaqeni s'i shqitej peshkut.

- Ashtu?- tha plaku dhe ia nguli thikën në mes të trurit dhe unazave të kurrizit. Tani kjo gjë s'ishte e vështirë dhe ndieu se thika preu kërcin. Plaku e ktheu lopatën nga ana tjetër dhe ia futi peshkaqenit në gojë, që t'ia hapte nofullat. E rrotulloi lopatën dhe, kur peshkaqeni u shkëput nga peshku tha:

- Shko poshtë, galanos. Shko poshtë një milje. Shko se e gjen atje shokun. Apo mos ishte nëna jote?

Fshiu faqen e thikës dhe e la lopatën në varkë. Pastaj rregulloi pëlhurën dhe, kur ajo gufoi nga era, e ktheu varkën në drejtimin e mëparshëm.

- Ata kanë marrë me vete sigurisht një të katërtën e peshkut, madje edhe mishin më të mirë,- tha me zë të lartë. – Sa mirë do të qe sikur kjo të ishte vetëm një ëndërr dhe të mos e kisha zënë këtë peshk! Keq më vjen, o peshk, që na ngjau kjo gjë. Na prishi shumë punë.

Plaku pushoi; ai s'kishte qejf ta vështronte peshkun tani. Ngjyra e tij i shëmbëllente ngjyrës së amalgamit me të cilën mbulojmë pasqyrën, por vijat e tij dukeshin ende.

- S'duhej të shkoja kaq larg në det, o peshk, tha. – keq më doli, edhe mua edhe ty. Keq më vjen shumë, o peshk...

*Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

---

*Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën e përgjigjes së saktë.*

- 11.** Në veprën “Plaku dhe deti” vëmendja e Heminguejit është drejtuar te: **1 pikë**  
A) plaku Santiago,  
B) djali Manolo,  
C) arti i lundrimit,  
D) skuadra e bejzbollit.
- 12.** Në rrëfimin e Heminguejit spikat: **1 pikë**  
A) përshkrimi i tragjikes,  
B) miti i Sizifit,  
C) parimi i ajzbergut,  
D) përshkrimi i hollësishëm.
- 13.** Gjendja psikologjike e Santiagos është: **1 pikë**  
A) e gëzuar,  
B) e pezmatuar,  
C) e irrituar,  
D) e tensionuar.
- 14.** Heminguej është shkrimtar: **1 pikë**  
A) simbolist,  
B) sentimentalist,  
C) ekzistencialist,  
D) i “Brezit të humbur”.
- 15.** Në këtë prozë del natyrshëm ideja e: **1 pikë**  
A) dashurisë së përjetshme,  
B) luftës për ekzistencë,  
C) lirisë absolute,  
D) tjetërsimit të individit.
- 16.** Përqëndrohu në fragment për të portretizuar figurën e plakut Santiago. A do të ishte i motivuar ai pa luftën në det? Mendimin tënd argumentoje me detaje dhe pjesë nga fragmenti. **4 pikë**

*Matura Shtetërore 2006, Teste*

---

- 17.** Nisur nga fjalia përmbyllëse e këtij fragmenti, shpjego një nga veçoritë dalluese të stilit të Heminguejit. **3 pikë**
- 18.** Trego dhe shpjego kuptimin e disa prej simboleve të përdorura (të paktën dy prej tyre). **4 pikë**
- 19.** Heminguej e bën plakun vazhdimisht të meditojë e të filozofojë. A mendon se autori e tepron në këtë drejtim apo është e natyrshme që një peshkatar plak të mendojë kështu pa e ditur se po filozofon? Shpreh mendimin tënd. **3 pikë**
- 20.** Kjo vepër e Heminguejit është konsideruar nga kritika si një përpyetje madhështore e njeriut për mbijetesë. Por, në këtë ndeshje ka humbës dhe fitues. A pajtohesh me këtë mendim? Argumento qëndrimin tënd duke iu referuar fragmentit ose edhe veprës në tërësi. **6 pikë**